



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr 02.052-66469 dt. 28.12 2022

Bazuar në nenin 11, 12. pika 12.1, 12.2 pika d, dhe 40, të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit Nr.04/-L-027, për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera si dhe Rregullores (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e jashtëzakonshme e mbajtur me datë, **28.12. 2022**, miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Raportit të Komisionit Komunal përfundimtarë për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera

Neni 1

Me këtë vendim në përputhje me nenin 31, paragrafi 1.1, të Rregullores (QRK) Nr.17.2015, për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, propozohet miratimi i Raportit të Komisionit Komunal përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera .

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi miratohet vlerësimi i dëmeve në shumën totale prej, 108,983 euro dhe atë 59.630.02 euro për dëme në ekonomi Familjare dhe 43.120 euro për dëme në Biznese, dhe për dëme në Bujqësi 6232.81,00.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari

ARSYETIM

Raporti i Komisionit Komunal përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera është një dokument i hartuar në përputhje me ligjin Nr.04/-L-027 për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera dhe Rregulloren (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera e cila i obligon komunat që të themelojnë komisionet për vlerësimin e këtyre dëmeve përmes së cilit është bërë vlerësimi i tyre me qëllim të përcaktimit të llojit dhe madhësisë së dëmit në të mira materiale e shprehur në vlerë monetare të nevojshme për kthimin e të mirave materiale të dëmtuara apo shkatërruara në gjendjen e tyre paraprake, përkatësisht në vlerën e cila është e nevojshme që këto të mira materiale të blihen apo riparohen. .

Një dokument i tillë u drejtohet me propozimin për miratimin e tij duke marrë parasysh faktin se sipas legjislacionit në fuqi Kryetari i Komunës obligohet që së bashku me mendimin e tij të njëjtin ta dorëzoj në kuvendin komunal për shqyrtim dhe miratim ku edhe pas miratimit i njëjti në afatin prej 15 ditëve dorëzohet tek Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe një kopje Komisionit Qendrorë të vlerësimit të dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera i cili më pastaj konstaton për korrektësinë apo për mangësitë eventuale të tij .

Andaj duke pasur parasysh këtë si dhe rekomandimet e Komisionit Qendrorë të vlerësimit të dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera lidhur me procedurën e shqyrtimit të raporteve të komunave për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale dhe ndikimi i fatkeqësive tjera propozon që brenda afatit ligjorë dhe në përputhje me nenin 31 paragrafi 1.1 I rregullores (QRK) (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera të miratoj këtë propozim vendim .